



Planuar / Dorezuar Prijemjen/Protato Received/Delivery	18.11.2021	viti god year	
Organ /Njesia Organ /Jednitca Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	5531/2021		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

Anr.827/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshef Shabanii-Kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Arben Mehemi – anëtar, Zyle Millaku-Gojnovci, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit kanë shqyrtuar ankesën e datës 21.09.2021 të ankuses me numër A.Nr.827/2021, me adresë banimi rruga "Tomas Xhefrson", pa nr.fshati Llozhan Komuna e Pejës, kundër organit të punësimit Agjencisë së Kosovës për Forenzik, në çështjen juridike "**Kompensim material**", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregullores Nr. 03/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës /në seancën për këshillim dhe votim me datë 18.11.2021, mori këtë;

V E N D I M

I.APROVOHET pjesërisht ankesa me numër A.nr.827/2021 e datës 21.09.2021 e parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Agjencinë së Kosovës për Forenzikë, në vendin e punës Specialiste e lartë në Divizionin për Balistikë, sipas kontratës së punës të datës 22.07.2013 (tash e tutje ankuesja).

Ankuesja me datë 11.08.2021 ka parashtruar kërkesë tek UD. Drejtorit të Departamentit të Traseologjisë Forensike, për kompensimin material të 50% të pagës mujore për çdo fund vit, nga hyrja në fuqi të Ligjit Nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikës (tash e tutje AKF), konform nenit 20 paragrafit 3, duke filluar nga viti 2011 deri më sot.

Me datë 23.08.2021 ankuesja ka pranuar përgjigje nga UD.Drejtorit të Departamentit të Traseologjisë Forensike, në të cilën shkresë nga ana e ud.drejtorit është dhënë përgjigje lidhur me shkresën e ankuses.

Ankuesja e pa kënaqur me përgjigjen e UD.Drejtorit të Departamentit të Traseologjisë Forensike, me datë 21.09.2021, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ankesa në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është regjistruar me datë 21.09.2021 dhe është protokolluar me numër protokollit 4724/21.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 23.09.2021, ka dërguar kërkesë për përgjigje të ankueses në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë, , ndërsa me datë 30.09.2021 AKF kanë dërguar përgjigjen me shkresat e bashkangjitura, si dhe provat shtesë E-mailit të datës 04.11.2021, sipas kërkesës së Këshillit në formë elektronike.

Me datë 04.11.2021 Kryesuesi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerre Vendimin me numër protokollit 5293/21, me të cilin ka miratuar kërkesën e Kryetarit të Kolegjit, për shtyrjen e afatit të ankesës A.nr.827/2021, konform dispozitave ligjore në fuqi, duka pasur parasysh rrethanat e funksionimit të KPMSHCK-së.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.Nr.827/2021 te datës 21.09.2021 me numër te protokollit 4724/21; Kontratë e punës e datës 22.07.2013; Përgjigje e datës 23.08.2021; Kërkesë e datës 11.08.2021; Përgjigje në ankesë e datës 30.09.2021; Udhëzimi Administrativ Nr.35/2012 –MPB; Formulari i vlerësimit të punës, Udhëzim për kriteret e notimit; Udhëzimi Administrativ Nr.32/2012 –MPB; Aktgjykimin nr. ref.AGJ 1583/20 për rastin nr.KO203/19 të Gjykatës Kushtetuese; Kërkesë zyrtare elektronike Email, i datës 03.11.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 04.11.2021 dhe datës 05.11.2021.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështjeje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka vërtetuar se ankesa e ankueses është e bazuar pjesërisht, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka shqyrtuar pretendimin ankimor të ankueses lidhur me kompensimin material 50% të pagës mujore për çdo fund vit, nga hyrja në fuqi të Ligjit Nr.04/L-064 për Agjencinë e Kosovës për Forenzikës, konform nenit 20 paragrafit 3, duke filluar nga viti 2011 deri më sot dhe Udhëzimit Administrativ Nr.32/2012-MPB për Pagat, Shtesat dhe Dobitë Tjera të Punonjësve në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, lidhur me pretendimet ankimore të ankueses e cila ka pozitën "Specialiste e lartë", në Divizionin për Balistikë në AKF, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme, dhe njëherit ka analizuar infrastrukturën ligjore së cilës ju kanë nënshtruar punonjësit e AKF-së, ashtu siç kanë njoftuar edhe AKF, këta punonjës deri në vitin 2013 kanë qenë në kuadër të Policisë së Kosovës dhe nuk ju kanë nënshtruar ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë, sepse nuk janë llogaritur nëpunës civil dhe si rrjedhojë nuk ka mundësi që KPMSHCK të trajtoj ankesën për këtë periudhë sepse është jashtë kompetencës lëndore të KPMSHCK-së.

Kolegji i Këshillit, konstaton se edhe Ligji Nr.04/L-064 për AKF ka rregulluar në mënyrë të veçantë edhe përhedhjen e Drejtorit të Përgjithshëm të AKF-së që ka qenë jashtë rregullativës së Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës.



Ndërsa pas hyrjes ne fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë nr.06/1-114 statusi i punonjësve të AKF-së ka ndryshuar, sepse neni 85 i këtij ligji ka shfuqizuar çdo dispozitë që është në kundërshtim me këtë ligj sa i përket marrëdhënies së punës të njëjtën gjë e ka konfirmuar edhe Gjykata Kushtetues e Republikës së Kosovës në Aktgjykimin e datës 09.07.2020 në rastin KO203/19 (shih pjesën e aktgjykimit të përmendur në pjesën ku flet për punonjësit e AKF dhe shërbyesit civil në policinë e Kosovës).

Nisur nga fakti i pa kontestueshëm se në Ligji Nr.04/L-064 për AKF në nenin 20 paragrafi 3 përcaktohet se “ Punonjësit e AKF-së të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i ndonjë veprimi disiplinor, përfitojnë si shpërblim 50% të pagës së rregullt mujore dhe atë vetëm një herë në vit”.

Kolegji i Këshillit duke pasur parasysh këtë dispozitë ligjore dhe duke konstatuar se vlerësimi i punës hynë në kuadër të marrëdhënies së punës, do ta shtjelloj vlerësimin e punës sipas Rregullores 19/2012 me qëllim të krahasimit se çka nënkuptohet vlerësimi i “KNAQËSHËM” që përmend dispozita e lartshënuara dhe së cilës i referohet ankuesja.

Rregullorja 19/2012 {Rregullore tashmë e shfuqizuar, por Kolegji i referohet për qëllime kahasimore} në nenin 7 sqaron në detaje kuptimin e notave lidhur me vlerësimin si vijon

Neni 7

Notat e vlerësimit 1. Vlerësimi për realizimin e objektivave të punës përbën 60% të rezultatit final të vlerësimit, ndërsa vlerësimi i aftësive të nëpunësit civil 40% të rezultatit final të vlerësimit. 2. Objektivat dhe aftësitë vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati final i vlerësimit llogaritet sipas mesatares së fituar dhe pasqyrohet si vijon: 2.1. Nga 1 deri më pak se 1.5 nënkupton “dobët”; 2.2. Nga 1.5 deri më pak se 2.5 nënkupton “mjaftueshëm”; 2.3. Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton “mirë”; 2.4. Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton “shumë mirë”; 2.5. Nga 4.5 deri në 5 nënkupton “shkëlqyeshëm”. 3. Kuptimi i notave në paragrafin 2 të këtij neni është si në vijim: 3.1. “shkëlqyeshëm”, vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar edhe aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon shumë pritjet. Po ashtu ata që kanë kontribuar thelbësisht në realizimin e objektivave të njësisë organizative, gjegjësisht të institucionit. 3.2. “shumë mirë”, vlerësohen nëpunësit civil, të cilët jo vetëm i kanë arritur të gjitha objektivat e punës (përmes realizimit të gjitha aktiviteteve), por kanë treguar aftësi dhe cilësi të punës, që tejkalon pritjet, kanë kontribuar në realizimin e objektivave të njësisë organizative.

Po ashtu Kolegji ju ka referuar me qëllim të krahasimit edhe Rregullores Nr.21/2021 për Avancim në Kariere {Rregullore tash më e shfuqizuar, por Kolegji i referohet për qëllime të krahasimit} gjegjësisht

Neni 9

Kriteret për avancim në karrierë

1. Kriteret për avancim në karrierë janë:

.....

1.4 rezultatet e vlerësimit në punë të jenë: mirë, shumë mirë dhe shkëlqyeshëm,

Kolegji për shqyrtimin e ankesës gjithashtu i është referuar edhe Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil gjegjësisht nenit 11 i cili në paragrafin 2.1, 3.2 dhe 3.2 për avancim në hapa lidhur me pagat gjithnjë i referohet termit vlerësimi i punës duhet me qenë mirë, shumë mirë dhe shkëlqyeshëm.

Po ashtu Kolegji bazohet edhe në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë { Në bazë të aktgjykimit të GJK rasti KO203/19 ky ligj i zbatueshëm edhe për punonjësit e AKF} gjegjësisht në nenin:

Nenin 43
VLERËSIMI I REZULTATEVE NË PUNË

.....

10. Nivelet e mundshme të vlerësimit të rezultateve në punë janë: 10.1. shkëlqyeshëm; 10.2. shumë mirë; 10.3. mirë; 10.4. kënaqshëm ose mjaftueshëm; 10.5. jo kënaqshëm ose jo mjaftueshëm. 11. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas nën paragrafëve 10.4 dhe 10.5 të këtij neni, për përmirësimin e dobësive në sjelljen profesionale, mbikëqyrësi direkt, në bashkëpunim me NJBNJ të institucionit, miraton edhe një listë të moduleve të detyrueshme të trajnimit, që nëpunësi duhet t'i ndjekë vitin që vjen. 12. Në rastin e vlerësimit në nivelet sipas nën paragrafëve 10.4 dhe 10.5 të këtij neni, nëpunësi civil nuk mund të aplikojë për lëvizje brenda kategorisë dhe për një konkurrim të mbyllur për një pozitë të kategorisë së lartë drejtuese.

Meqenëse se tashmë Kolegji ka konstatuar se vlerësimi i punës hynë në kuadër të marrëdhënies së punës, si dhe duke marrë parasysh edhe dispozitat krahasimore të cilat janë analizuar me qëllim që të të vihet në një përfundim sa i përket fjalisë së përdorur në nenin 20 pikën 3 ku thuhet “Punonjësit e AKF-së të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm”, Kolegji është i mendimit se vlerësimi kënaqshëm nënkupton një vlerësim që është i barasvlershëm me vlerësimin e shkëlqyeshëm i përcaktuar në nenin 43 nën paragrafi 10.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu në përputhje me nenin 85 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë i cili përcakton se “ **Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil nr. 03/L-149 i Republikës së Kosovës dhe çdo dispozitë tjetër në kundërshtim me këtë ligj**”, Kolegji konstaton se vlerësimi i kënaqshëm i punonjësve të AKF-së nuk është bazë për zbatimin e nenit 20 paragrafi 3 të ligjit të lartpërmendur për AKF.

Kolegji konstaton se sa i përket pagave është në fuqi Ligji Nr.03/L-147 për nëpunësit civil, i cili ligj në nenin 27 të tij shfuqizon vetëm aktet nën ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj, por nuk bënë fjalë për dispozitat ligjore që janë në kundërshtim me këtë ligj, prandaj nisur nga ky fakt punonjësve të AKF-së ju takon ky shpërblim i përcaktuar në nenin 20 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 04/L064 për AKF, POR vetëm punonjësve që vlerësohen shkëlqyeshëm nga ana e mbikëqyrësit të drejtpërdrejt konform të dispozitave ligjore dhe akteve nën ligjore që janë në fuqi sa i përket vlerësimit të punës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave nuk ka marr për bazë Udhëzimin Administrativ Nr.35/2012 për Procedurat dhe Kriteret e Vlerësimit dhe Notimit të Punonjësve të AKF-së, sepse vlerësimi është sitëm unikë në bazë të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe njëherit i rekomandohet Ministrit të MPB-së që të trajtoj ligjshmërinë e këtij akti nënligjor.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA ANR. 827/2021**



Zyle Millaku-Gojnovci

Procesmbajtës

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Kryeshefit Ekzekutiv në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë,
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë,
- Arkivit të KPMSHCK-së .